



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të masave të marra nga qeveria shqiptare për parandalimin e përhapjes së Covid-19, si dhe në kushtet e ndalimqarkullimit, përmes strukturave të saj po monitoron sjelljen e tregjeve për të shmangur çdo abuzim të mundshëm nga tregtarët.

Për këtë qëllim është në dispozicion edhe numri i gjelbër pa pagesë **0800 14 14**, ku të gjithë mund të bëjnë denoncime të rasteve që konstatojnë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë inkurajon qytetarët që të përdorin këtë mjet komunikimi, për të ndihmuar në evidentimin e rasteve, të cilat do të ndiqen me prioritet, bazuar kjo edhe në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorit” i cili përcakton ndalimin e praktikave të padrejta tregtare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, nuk përbëjnë vepër penale, por kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me penalitetet përkatëse në fuqi.



The Ministry of Finance and Economy, in the framework of measures taken by the Albanian government to prevent the spread of Covid-19, as well as being under the circulation ban, is monitoring the behavior of markets through its structures, aiming to avoid any possible abuse by merchants.

The toll-free number **0800 14 14** is available for this purpose, where anyone can report any abuse cases. The Ministry of Finance and Economy encourages citizens to use this communication tool to help identify cases that will be pursued with priority, based also on the “Law on Consumer Protection”, which provides the prohibition of unfair commercial practices in order to protect the consumer.

Violations of the provisions of this law shall not constitute a criminal offense, but shall constitute an administrative offense and shall be punished with the relevant penalties in force.